REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.3378/2016

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Zenel Leku, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit SH.SH. nga Prishtina, Rr. "..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.SH., avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve 'S... në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit K.P., punëtor i të njëjtës, për shpërblim dëmi nga baza e autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 1.648,40 Euro, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3226/12, i datës 22.03.2016, në seancën jo publike të mbajtur me datë 12.06.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "S... në Prishtinë dhe VERTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3226/12, i datës 22.03.2016.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.3226/12, i datës 22.03.2016, ka vendosur:

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit SH.SH. nga Prishtina, DETYROHET i padituri Kompania e Sigurimeve 'S..., në Prishtinë që paditësit t'ia kompensojë dëmin material që ju është shkaktuar në aksidentin dt.22.12.2011, në Gjilan, në automjetin Audi A6, me targa ..., në shumë 1.648.40 Euro dhe shpenzimet e procedurës, në shumë 514.00 Euro, në afatin prej 15 ditëve.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, duke e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim bërë gjykatës së shkallës së dytë që aktgjykimin e atakuar t'a prishë dhe lëndën t'ia kthejë në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë, apo të njëjtin aktgjykim ta ndryshojë duke gjykuar, ashtu që për shumën 1.413,40 Euro, të vërtetohet pjesërisht aktgjykimi i shkallës së parë, ndërsa shuma tatimore prej 235 Euro të refuzohet si e pabazuar.

Paditësi nuk ka dhënë përgjigje në ankesë,

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe gjeti se :

-Ankesa e të paditurës nuk është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij në gjykatën e shkallës së parë, ka ushtruar padi kundër të paditurës, të cilën së fundi herë e ka precizuar në seancën e mbajtur më datë 22.03.2016, duke kërkuar që gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave të propozuara të detyroj të paditurën, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të dëmtimit të veturës së tij në aksidentin e ndodhur me datën 22.11.2011, në Gjilan, aksident ky i shkaktuar me fajin e të siguruarit të paditurës, e nga baza e autopërgjegjësisë, t'ia paguajë shumën prej 1.648,40 Euro.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën sipas propozimit të palëve, ka nxjerrë dhe administruar provat nga shkresat e lëndës, me vlerësimin e të cilave ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ku edhe ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.3226/12, i datës 22.03.2016, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të të njëjtit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Aktgjykimi i ankimuar po ashtu del të mos jetë përfshirë as në shkelje tjera procedurale sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese.

Pretendimi ankimor i palës së paditur se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 i LPK, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është pretendim tërësisht i paqëndrueshëm, për faktin se kjo gjykatë konstaton se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata e shkallës së parë qartë dhe në mënyrë të plotë ka arsyetuar faktet se pse në rastin konkret është aprovuar kërkëspadia e paditësit, duke dhënë sqarime të mjaftueshme qoftë sa i përket të provuarit të fakteve lidhur me themelësinë e kërkespadisë por edhe lartësinë e saj, arsyetim dhe përfundim ky i gjykatës së shkallës së parë i cili është i pranueshëm edhe për këtë gjykatë.

Sa i përket dëmit material të gjykuar paditësit, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka vlerësuar dhe gjykuar shumën lidhur me dëmin material, pasi që në rastin konkret sipas vlerësimit të ekspertit të makinerisë Ing.N.SH., i caktuar nga gjykata e shkallës së parë është përcaktuar qartë se dëmi material i shkaktuar paditësit në veturën e tij, si pasojë e aksidentit të shkaktuar me lëshimet dhe fajin e të siguruarit të të padituës është në shumën prej 1,648.40 Euro, e të cilës ekspertizë ashtu sikurse gjykata e shkallës së parë, besimin ja fal edhe kjo gjykatë duke vlerësuar se e njëjta është e punuar nga eksperti profesional i lëmisë përkatëse është e qartë, e plotë, e arsyetuar mjaftueshëm dhe ka mbështetje të plotë edhe në provat tjera nga shkresat e lëndës.

Pretendimi ankimor i të padituës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, pasi që vendimin e saj e ka bazuar në ekspertizën e ekspertit të makinerisë të caktuar nga gjykata, ekspertizë kjo që nuk përkon me dëmin real të shkaktuar paditësit, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë për shkak se kjo gjykatë me vlerësimin e të njëjtës ekspertizë për të cilën konsideron se është e punuar në mënyrë profesionale, ka konstatuar se paditësi ka pësuar dëm në shumën e gjykuar sipas të gjeturave të bëra nga eksperti i makinerisë.

Nën rrethanat e tilla kjo gjykatë i ka vlerësuar tërësisht të pabazuara pretendimet ankimore të palës ankuese sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare sa i përket lartësisë së kërkespadisë e cila gjatë shqyrtimit kryesor ka qenë kontestuese në mes ndërgjygjësve, ku edhe ka dhënë arsye të mjaftueshme, me çka aktgjykimi i ankimuar për nga përmbajtja e tij i plotëson kushtet e kërkuara me nenin 160 të LPK-së, dhe mbi gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, drejtë nga gjykata e shkallës së parë janë zbatuar edhe normat e ligjit material.

Përgjegjësia e te padituës që të kompensoj paditësin gjen mbështetje në dispozitat ligjore të nenit 154, 155, 178 dhe 185 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD), e lidhur me Rregullin 3, mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë.

Drejtë, gjykata ka vendosur edhe lidhur me shpenzimet procedurale të gjykuara paditësit pasi që e paditura si palë e cila ka humbur kontestin gjyqësor në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka për detyrim që paditësit si palë gjyq fituese t'ia shpërblej shpenzimet gjyqësore, ku shpenzimet e njohura paditësit nga gjykata e shkallës së parë me shikimin ne shkresat e lëndës rezulton se janë në përputhje të plotë me shpenzimet e nevojshme që paditësi ka pasur gjatë procedurës për

ndjekjen e çështjes në gjyq, e që i referohen shpenzimeve lidhur me përfaqësimin në procedurë nga i autorizuari i tij, taksave gjyqësore për padi dhe aktgjykim dhe nxjerrjen e provës me ekspertin nga lëmi i makinerisë.

Nga arsyet e cekura, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 195 paragrafi 1 pika (d), e lidhur me nenin 200 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3378/2016, me datë 12.06.2020

Kryetari i kolegjit
Qerim Ademaj, d.v.